



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 92, datë 29.06.2020

PËR

**MIRATIMIN E ANËTARIT TË KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT DHE TË
ADMINISTRATORIT TË SHOQËRISË SË BROKERIMIT NË SIGURIME TË JETËS
DHE TË JO-JETËS “ABI BROKER SIGURIMESH” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Rregullores nr. 48, datë 30.06.2015 “Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime” Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e zj. Brunilda Papa, në pozicionin e anëtarit të Këshillit të Administrimit të shoqërisë së brokerimit “ABI Broker Sigurimesh” sh.a., për një periudhë 3-vjeçare.
2. Miratimin e zj. Veronika Prifti, në pozicionin e Administratorit të shoqërisë së brokerimit “ABI Broker Sigurimesh” sh.a., për një periudhë 3-vjeçare.
3. Miratimin e ndryshimit të pikës 9.4, të nenit 9 dhe pikës 10.3, të nenit 10, të statutit të shoqërisë së brokerimit “ABI Broker Sigurimesh” sh.a., si vijon:

“9.4. Anëtarët e KA janë:

- *Igli Sulaj i datëlindjes 28.05.1981, lindur në Tiranë, shtetas shqiptar;*
- *Veronika Prifti, e datëlindjes 06.09.1962, lindur në Tiranë, shtetase shqiptare;*
- *Brunilda Papa, e datëlindjes 09.07.1973, lindur në Vlorë, shtetase shqiptare”.*

“10.3. Administratori i shoqërisë “ABI Broker Sigurimesh” sh.a., është Zj. Veronika Prifti, e datëlindjes 06.09.1962, lindur në Tiranë, shtetase shqiptare”, deri në 31.03.2023.

4. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimet dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR
Deniz DERALLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE